



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 387 Prot.

Tiranë, më 12.01.2020

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare Nr.1687, datë 07.02.2014.

SHOQËRISË “BERALB” SH.A
Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 13, Tiranë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “BERALB” sh.a e cila është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1687, datë 07.02.2014, për mineralin e bakrit në objektin “Palucë”, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nëpërmjet shkresës Nr.4492, datë 09.12.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.8599 Prot, datë 10.12.2020, është propozuar revokimi për Lejen e shfrytëzimit Nr.1687, datë 07.02.2014, për mineralin bakër, në objektin “Palucë”, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër, sepse shoqëria nuk ka filluar aktivitetin minerar në objekt në afatin e përcaktuar nga hyrja në fuqi e lejes, brenda 180 ditëve kalendarike, si dhe zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit për 2 vjet radhasi dështon në realizimin e 90% të vlerës së investimit, që ka parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gremat “ii” dhe “f” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1687, datë 07.02.2014, për mineralin**

bakër, në objektin “Palucë”, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1687, datë 07.02.2014, për mineralin bakër, në objektin “Palucë”, Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA**

